

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit A.I.M. nga fshati G., Komuna e P., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.II.5703/2014 të dt.30.10.2015, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të shtetit Hava Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, dhe të pandehurit A.M., si dhe të dëmtuarve B.M. dhe H.M., më datën 30.12.2015, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: **A.M.**, nga babai I., dhe nëna F., e vajzërisë J., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin G., Komuna e P., nr. personal *numri personal...*, ka të kryer Fakultetin Juridik, i martuar baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomiko sociale, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Më datë 18.07.2014, rreth orës 12:50, në fshatin G. për në K., i pandehuri A.M., derisa ishte duke e drejtuar automjetin e tipit "Citroen Xantia", me targa regjistrimi *targat e regjistrimit...*, ngjyrë e kaltër, nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe të pasurisë në atë mënyrë që, ka vepruar në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së, ashtu që me të arritur në afërsi të lagjes së Bajgorëve, nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit, me ç'rast humb kontrollin ndaj automjetit, i cili fillon të bartet, duke dalur jashtë në anën e djathtë të rrugës pastaj, me pjesën e përparme të automjetit godet betonin-gypin e ujërave atmosferike, dhe nga përplasje e automjetit përfundon në rrugë, ku si pasojë e aksidentit lëndime vdekjeprurëse ka pësuar pasagjeri-prindi i të pandehurit I.M., ndërsa pasagjerët-vëllezërit dhe nipi H.M., B.M., M.M., sipas ekspertizës mjeko ligjore kanë pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

- Më këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Në mbështetje të nenit 78 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së,

L I R O H E T N G A D Ë N I M I

Me këtë aktgjykim i pandehuri **A.M.**, lirohet nga dënimi për shkak se pasojat e kësaj vepre penale e kanë goditur aq rëndë kryerësin sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej **122.64 Euro**, (për ekspertizën e komunikacionit) si dhe shumën prej **50.00 Euro**, (për ekspertizën mjeko ligjore), ndërsa në emër të shpenzimeve paushallë shumën prej **30 Euro (tridhjetë euro)**, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit B.M., H.M. dhe M.M. me përfaqësuesin e tij ligjor-prindin të gjithë nga fshati G., Komuna e P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.nr.II.5703/2014 të dt.30.10.2015, ka akuzuar A.I.M. nga fshati G., Komuna e P., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt.30.12.2015, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit Hava Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i pandehuri A.M., si dhe të dëmtuarit B.M. dhe H.M.

I pandehuri A.M., në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas të gjitha pikave të aktakuzës si dhe ka theksuar se me vjen keq për rastin që ka ndodhur në këtë rast me e dëmtuara është familja ime dhe unë vetë personalisht ngase në këtë aksident ka humbur jetën babai im I.M. dhe janë lënduar rëndë vëllezërit e mije B.M. dhe H.M. dhe nipi im M.M., po ashtu lëndime të rënda kam pësuar edhe unë. Rasti ka ndodhur nga pakujdesia nuk kam pasur qëllim që të lëndoj askënd i kërkoj gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana dhe i premtoj gjykatës që do të jem shume i kujdesshëm në trafik.

Prokurori i Shtetit Hava Krasniqi, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i njëjti është në përputhje me dispozitat e kodit të procedurës penale, si dhe në përputhshmëri me shkresat e lëndës, andaj i propozoi gjykatës që të njëjtin të aprovoje. Ndërsa pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese.

I dëmtuari B.M., në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se i propozoi gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë nga ana e vëlluat tim, ne si familje në këtë aksident kemi humbur mjaftë shumë prindin, andaj i propozoi gjykatës që vëllaun tim A. të liroj nga dënimi, ngase unë nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale ndërsa kompensimin e demit e bëj pranë kompanisë së sigurimit ku ka qene vetura e siguruar.

I dëmtuari H.M., në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se i propozoi gjykatës që të aprovoje pranimin e fajësisë ngase në këtë rast si familje kemi pësuar të gjithë edhe i propozoi gjykatës që të liroj vëllaun tim nga dënimi, ndërsa kompensimin e demit të ta bëjë nga kompania e sigurimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuar nga prokurori i shtetit.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarve, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar

procedurën e provave, ashtu që të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë aktgjykim, meqë konsiderojmë se si vepra penale ashtu edhe përgjegjësia penale u vërtetua nga pranimit i fajësisë së të pandehurit.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë vullnetarisht, gjykata e vlerësoi dhe analizoi se pranimit i fajësisë ka mbështetje në vërtetim të gjendjes faktike, në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit Ing. Dip. M.H. të datës 21.04.2015, në konkluzionin e ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. F.D. i dt.28.06.2015, lidhur me llojin dhe natyrën e lëndimeve, si dhe dokumentacioni tjetër i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të pandehurit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtorë.

Sa i përket fajësisë gjykata gjeti se i akuzuari e ka kryer veprën nga pakujdesia, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe sjellja e cila i lejon shoferit që të kontrolloj mjetin, si dhe kushteve e rrethanave të rrugës, me ç'rast si pasojë e kësaj edhe shkaktohet aksidenti.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do të zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës dhe e ka shpallur fajtor, ndërkaq e liroi nga dënimi në mbështetje të dispozitave të nenit 78 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së, meqenëse i pandehuri, viktimën e kishte prindin-babain e tij, kurse të dëmtuarit tjerë janë vëllezërit dhe nipi i tij, se humbja e prindit dhe lëndimi i vëllezërve dhe nipit të tij e ka goditur aq rëndë të pandehurin, sa që shqiptimi i ndonjë dënimi eventual nuk mund t'i tejkalojë dhimbjet dhe ndjenjat e fajit dhe të përgjegjësisë që ndien vet i pandehuri në këtë rast. Duke pas parasysh këto fakte dhe rrethana, sipas bindjes së gjykatës shqiptimi i ndonjë dënimi do të jetë tërësisht i pa nevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të dispozitave të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
P.nr.1029/2015 më dt.30.12.2015

Gjyqtari:
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.